



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 130/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Ferit Osmani dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Sami Gashit, Kastriot Veliju dhe Besim Osmani, Anëtarë të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), në Novobërdë, paraqitur kundër Anëtarëve të KKZ-së, në Novobërdë, Arben Avdyli, Serba Gjokiq dhe zyrtarit ekzekutiv të KKZ-së Selim Mehmeti, për shkak nominimit të Kryesueseve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV), në kundërshtim më nenin 77.3 dhe nenin 77.4, për Zgjedhjet Lokale të 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 01.10.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si i palejueshëm apeli i Anëtarëve të Komisionit Komunal Zgjedhor të Komunës së Novobërdës Sami Gashit, Kastriot Veliju dhe Besim Osmani parashtruar kundër nominimit të kryesueseve të këshillave të vendvotimit.

Arsyetim

Anëtarët e KKZ-së në Novobërdë, Sami Gashi, Kastriot Veliju dhe Besim Osmani, me datën 30.09.2013, kanë parashtruar apel në PZAP, në të cilin theksojnë se anëtarët e KKZ-së, në Novobërdë, Arben Avdyli, Serba Gjokiq, si dhe Zyrtari ekzekutiv i KKZ-së, Selim Mehmeti, kanë shkelur procedurat ligjore duke bërë nominimin e anëtarëve për Kryesues të KVV-ve, në kundërshtim me nenin 77.3.4 të LZP-së. Më tutje parashtruesit e apelit theksojnë se ndarja e kryesueseve është bërë në kundërshtim me procedurat ligjore, në radhë të parë duke mos tërhequr shortin, për ndarje të vendvotimeve, i cili sipas tyre ju takon subjekteve politike siç janë: SLS, LDK, PDK, dhe VV, ku sipas parashtruesit të apelit këtë shkelje e dëshmon fakti i mos mbajtjes së procesverbalit për ndarje të shortit për vendvotime si dhe nominimin e KVV-ve. Gjithashtu parashtruesi i apelit thekson se në proporcion me vendvotimet, ku prej 21 VV, në Komunën e Novobërdës, një subjekt politik duhet të ketë 5 (Pesë) kryesues të KVV-ve, kjo barazi nuk ekziston, por sipas tyre është përdorur vetoja e forcës dominuese politike e LDK-së dhe SLS-së, duke i për zgjedhur kryesuesit e KVV-ve sipas interesit politik.

Parashtruesit e këtij apeli propozojnë që PZAP, të bëjë anulimin e këtyre nominimeve, e njëkohësisht kërkojnë zbatimin e dispozitave ligjore të neneve 77.3, neni 77.4 të LZP-së.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e apelit, dhe gjeti se:

apeli është e palejuar

Ankuesit në apelin e tyre pretendojnë se nominimet e Kryesuesve të KVV, në Komunën e Novobërdës janë bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 77 pika 3 dhe 4 të LZP-së. PZAP-i konstaton se këto pretendime ankimore nuk janë në juridiksionin e këtij institucioni për të vendosur sipas nenit 122.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) ngase PZAP-i, vendos vetëm për disa vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht me dispozitën e sipërshënuar, meqenëse pretendimet ankimore nuk janë në përputhje me dispozitën e lart theksuar PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 130/2013 më datën 01.10.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.